

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/25/historia-e-dyshimte-e-ankandit-te-llatjas-si-u-be-kujt-im-llupa-pronar-i-klubit-te-elbasanit/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 19:14:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 19:11:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fb83809ed5c7168e0fba28efa5c8e6e06cb8a8fb06602e6b0e36f7f4246d2d6f
TEKSTI	32b290fd5e5f4f743f82bae3599b94e44b46b69dc65503e558db5f813b412be4
PAMJA	b996f8b6c59dec516d0824e0b9ddec30d521276d50de9a5e793022bb91484367

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1d62471b3be094d78fd584c82ee923eec9decd7b247e36796755f3446bb38613
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9fd2d6c8eaed582dbfbd973ad421bf483fa1abd0a548cdf1a11aa95128494a7b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1d62471b3be094d78fd584c82ee923eec9decd7b247e36796755f3446bb38613>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit

Kryesore

Publikuar: 25/09/2026



Klubi i futbollit të Elbasanit kalon formalisht në pronësi të sipërmarrësit Kujtim Llupa. Shitja e realizuar pak ditë më parë është një rrjedhim logjik i raporteve shumë-vjeçare të Llupës me skuadrën, por që për arsye të paqarta pronësia e skuadrës ka kaluar në transaksione në dukje të panevojshme.


Kujtim Llupa luan praktikisht rolin e “Presidentit të ekipit” prej vitesh, megjithëse nuk ka rezultuar asnjëherë aksioner i tij.

Në vitin 2023, Bashkia e Elbasanit kaloi 70 përqind të aksioneve nëpërmjet një procedure ankandi tek një shoqëri e panjohur publikisht dhe pa asnjë lidhje të dukshme me sportin, “Blaed Trade”. Vlera e ankandit ishte 13 milionë lekë të reja. Kompania fituese e ankandit ka pasur më herët ortak Arben Gjoshin, një personazh i lidhur me Kujtim Llupan në disa shoqëri të tjera, përfshirë “Premium Distribution”, “Intis Co” dhe “Sentinel Soft”. siç ka **raportuar** më herët “**Boldnews.al**”.

Klubi i Elbasanit “tek i zoti”

Në 22 Korrik 2026, “Blaed Trade” shpk vendos të shesë të gjithë aksionet që zotëron tek “Akademia e Futbollit Elbasan”, në total 70 përqind.

Blerësi është shoqëria “TechConsult”, e themeluar në vitin 2024 dhe në pronësi të plotë të biznesmenit Kujtim Llupa.



Me të lexuarat

- Skandal/ Shefin e Komisarit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shullën në mes të rrugës
- Gazini Bregu që ndërtoi vilën e Ahmetajt në Hamallaj, përfitoi 20 milionë euro nga vendi...
- arrestua në Rusi, zbulohet portreti i Shpëtim Aliut! (“Kumbari” që furnizoi me AKSHI-t hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e krye)
- Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit



Në foto: Sipërmarrësi Kujtim Lllupa

Sipas akteve të lexuar nga “**Boldnews.al**”, rezulton se kontrata e shitjes është “me kusht”. Palët bien dakord që vlera e transaksionit është në shumën 16 milionë lekë të reja.

Blerësi, pra kompania “TechConsult” e Kujtim Lllupas bie dakord që të paguajë shumën në dy këste- pagesa e parë, në shumën 12 milionë lekë të reja është vendosur të likujdohet Brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Ndërsa kësti i dytë, në shumën 4 milionë lekë të reja, duhet paguar brenda 3 muajve. Vetëm pas konfirmimit të pagesës së dy tësteve, “TechConsult” e Kujtim Llupas shndërrohet zyrtarisht në aksioneren kryesore të “Akademisë së Futbollit Elbasan”.

Megjithatë, kontrata me kusht është dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe Kujtim Llupa rezulton tashmë edhe zyrtarisht si aksioner në klubin “verdhë e blu”.

Ankandi i dyshimtë i Llatjas

Ekipi, i krijuar në vitin 1929, ka qenë për shumë kohë në pronësi të Bashkisë së Elbasanit. Në vitin 2021, pushteti lokal e shndërroi skuadrën në Shoqëri Aksionere, me emrin “AF Elbasani”.

Në vitin 2023, Bashkia organizoi një ankand për shitjen e 70 përqind të aksioneve të saj. Media e konsideroi këtë procedurë si një rutinë me fitues të (para) caktuar, duke përmendur emrin e biznesmenit Kujtim Llupa. Ai kishte kontribuar edhe më herët për skuadrën dhe gjithçka dukej formale.

Por, në përfundim të procesit, ankandi u fitua nga pjesëmarrësi i vetëm në procedurë, “Blaed Trade”, një kompani nga Lezha që nuk dukej se kishte lidhje, as me sportin dhe as me Elbasanin.

Në foto: Rezultatet e ankandit të zhvilluar nga Bashkia Elbasan për aksionet e “AF Elbasan”

Megjithatë, në një **publikim** të mëhershëm, “**Boldnews.al**” raportoi se, pavarësisht fituesit të ankandit, në ambjentet e skuadrës u shfaq si “pronar” biznesmeni Kujtim Llupa i cili

formalisht nuk ka asnjë raport me pronarët e rinj të “Af Elbasani”.

Gjithashtu, në atë raportim u ngritën pikëpyetje edhe mbi mënyrën se si u organizua ankandi nga kryebashkiaku Gledjan Llatja dhe, sidomos, vlera minimale fillestare e procedurës.

/boldnews

TAG:

Elbasan

Gjergj Ilatja

Kjtitim Ilupa

Të ngjashme

Ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

Grupi kriminal i AKSHI-t hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e Rrytajve), si po sfidohet SPAK dhe shqiptarët me kësh...

Skandali/ Shefin e Komisarariatit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shpulla në mes të rrugës në Durrës

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.